



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva  
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**  
**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency**

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

**KONKURS (i Brendshëm)**

**Titulli i pozitës:** Drejtor i Drejtorisë për Teknologji Informative

**Ref:** RN00002545

**Njësia Organizative:** Drejtoria e Administrates - AZHB

**Vendi i punës:** Prishtinë

**Kategoria funksionale:** Niveli drejtues

**Koeficienti:** 10

**Qëllimi i vendit të punës:**

Organizon, menaxhon , bashkrendon dhe rekomandon përmirësimin e punës në Drejtori. Siguron mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe zhvillimin e teknologjive të informacionit, përpunimin, qarkullimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në AZHB. Është përgjegjës për përgatitjen e planit të punës,ndarjen e funksioneve dhe detyrave brenda drejtorisë dhe raporton për punën.

**Detyrat kryesore:**

- 1.Udhëheqë dhe cakton objektivat e drejtorise në përputhje me strategjine dhe objektivat e AZHB-se dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për ti përmbushur këto objektiva; 20%
- 2.Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit;15 %
3. Përgatit,analizon dhe vlerëson planin vjetor për IT dhe pjesët hardware dhe identifikon nevojat për mbështetjen e IT, për të rritur eficiencyn, të përmbushë kërkesat për ndryshim të agjensisë etj. duke rekomanduar ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë; 15%
4. Kordinimi i punës në drejtori dhe dizanjimi i arkitekturës së rrjetit të Agjensisë. 15%
- 5.Organizon dhe mbikëqyr procesin e aplikimit në regjistrat e AZHB-se; 10%
6. Bënë hapjen dhe mbylljen e fushatës për aplikim për grande dhe subvencione ne regjistra te AZHB-se;10%
- 7.Administron sistemin e IT së Agjencisë dhe mban lidhje me regjionet dhe zyret komunale për bujqësi duke menaxhuar riskun dhe propozon zgjidhje për t’ i kaluar ose mënjanuar ato dhe planifikon vazhdimësinë; 10%
- 8.Bën vlerësimin e stafit dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve, seminareve, takimeve 5%

**Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:**

Njohuri paraprake ne fushën IT;

Diploma Universitare: **Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore (FSHMN), Fakulteti Ekonomik ose Relevant**-6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite përvojë në vende udhëheqese;

Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Shkathtësi në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, GIS, SQL, windows server,)

Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

**Data e shpalljes së konkursit me: 14.12.2017**

**Data e mbylljes së konkursit me: 21.12.2017**

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*

*“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës*

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Procedura e Aplikimit:** Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 23 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së [www.azhb-ks.net](http://www.azhb-ks.net).